

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Nr.prot.912/5

Date 07,01,2019

Për: "ALBANIAN MOTOR COMPANY" sh.p.k
Adresa: Autostrada Tirane-Durres, Km 10, Kashar, Tirane

* * *

Procedura e prokurimit: E Hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: Loti 1: REF-95912-11-26-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: së Loti 1: Blerje automjet kamioncine veteshkarkues per nevoja te autoritetit kontraktor. Sasia e kerkuar eshte dy automjete kamioncine veteshkarkues, me afat levrimi 140 dite.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.48, date 03.12.2018

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **O.E "ALBANIAN MOTOR COMPANY" sh.p.k** K41829010I
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera **6 497 500 (gjashte milion e katerqind e nentedhjete e shtate mije e peseqind) leke pa TVSH.**
(me numra dhe fjalë)
2. **O.E "R&R KOMPANI" sh.p.k** L72120030I
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera **6 700 000 (gjashte milion e shtateqind mije) leke pa TVSH.**
(me numra dhe fjalë)
3. **O.E "NOVAKTI" sh.p.k** L61415029I
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera **5 680 000 (pese milion e gjashteqind e tetedhjete mije) leke pa TVSH.**
(me numra dhe fjalë)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **O.E "R&R KOMPANI" sh.p.k** L72120030I
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
2. **O.E "NOVAKTI" sh.p.k** L61415029I
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

O.E “R&R KOMPANI” sh.p.k

1. U mor ne shqyrtim dokumentacioni administrativ ligjor i operatorit ekonomik “R&R KOMPANI” sh.p.k dhe u mbajt procesverbali i dokumenteve ligjore, bashkelidhur eshte printuar formulari i ofertes.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit administrativ ligjor te operatorit ekonomik “R&R KOMPANI” sh.p.k ne sistemin e APP rezulton se:

- Ka plotesuar te gjitha kriteret e pergjithshme te kualifikimit te kerkuara.

Kriteret e vecanta te kualifikimit – Kapaciteti ekonomik dhe financiar

1. Ne DST ne piken 1 eshte kerkuar nga autoriteti kontraktor ASHF “ *Kopje te certifikuara te bilanceve te dy viteve te fundit (2016-2017) te paraqitura ne autoritetet perkatese*”, ndersa operatorit ekonomik “R & R KOMPANI” sh.p.k i mungon bilanci i vitit 2016, sipas kriterit te vendosur ne dokumentet e tenderit si kusht per kualifikim.
2. Ne DST ne piken 2 eshte kerkuar nga autoriteti kontraktor ASHF “*Xhiroja vjetore per dy vitet e fundit (2016-2017) ku secila deklarate duhet te kete nje vlere jo me te ulet se 30 % e vleres se fondit limit te lotit 1*”, ndersa operatorit ekonomik “R & R KOMPANI” sh.p.k i mungon xhiroja vjetore e vitit 2016, sipas kriterit te vendosur ne dokumentet e tenderit si kusht per kualifikim.

Kapaciteti teknik

3. Ne DST ne piken 1 te kriterëve te tjera eshte kerkuar edhe “*Deklarata e permbushjes se specifikimeve teknike*”, e cila eshte paraqitur nga operatori ekonomik ofertues, ku deklararon sa me poshte: “*Une i nenshkruari Ramazan Rami, me cilesine e administratorit te personit juridik R&R KOMPANI sh.p.k deklaroj se: **Permbush te gjitha specifikimet teknike te percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe e vertetoj kete me certifikata e dokumenta (nese kerkohen nga autoriteti kontraktor), te dorezuara bashke me kete deklarate.***”

Ne DST ne piken 5 eshte kerkuar nga autoriteti kontraktor ASHF “*Operatori ekonomik duhet te paraqese nje katalog teknik te mallit qe oferton (te perkthyer ne gjuhen shqipe)*”, kriter i kerkuar me qellim qe autoriteti kontraktor te mund te njihet me te dhenat teknike te mjetit qe ofertuesi ka paraqitur, dokument i paraqitur nga operatori ekonomik ofertues.

Nga verifikimi i katalogut te te dhenave teknike te mjetit te paraqitur nga operatori ekonomik ofertues, rezulton se jo te gjitha specifikimet teknike te kerkuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentet e tenderit jane permbushur sipas deklarates te ofertuesit. Komisioni ka konstatuar mosperputhjet si me poshte:

Sipas shtojces 10 “Specifikimet teknike “ per lotin 1 ne DST eshte specifikuar:

- Konsumi ne litra per 100 kilometra jo me shume se 7.5 L/100 km, specifikim i kerkuar.

Specifikim qe nuk permbushet nga operatori ofertues, pasi sipas katalogut konsumi i karburantit eshte 8.0 L/100 km ne tejkalim te vleres se kerkuar.

- Lartesia e pergjithshme (maksimale) jo me e madhe se 2.200 m, specifikim i kerkuar.

Specifikim qe nuk permbushet nga operatori ofertues, pasi sipas katalogut lartesia e pergjithshme e mjetit eshte 2620mm, ne tejkalim te vleres se kerkuar.

Ne katalogun e te dhenave teknike te paraqitur nga operatori ekonomik ofertues nuk ka asnje te dhene per numrin e vendeve; per llojin e karburantit qe perdoret; vitin e prodhimit; modaliteti veteshkarkues.

Ne zbatim te nenit 53 pika 3 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006, "Per Prokurim Publik" (te ndryshuar) "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit.....", per sa me siper oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "R&R KOMPANI" sh.p.k shpallet e pavlefshme, pasi nuk ploteson te gjitha kriteret dhe specifikimet e kerkuara nga autoriteti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Funerale ne dokumentet e tenderit.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

O.E "NOVAKTI" sh.p.k

U mor ne shqyrtim dokumentacioni administrativ ligjor i operatorit ekonomik "NOVAKTI" sh.p.k dhe u mbajt procesverbali i dokumenteve ligjore, bashkelidhur eshte printuar formulari i ofertes.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit administrativ ligjor te operatorit ekonomik "NOVAKTI" sh.p.k ne sistemin e APP rezulton se:

- Ka plotesuar te gjitha kriteret e pergjithshme te kualifikimit te kerkuara.
- Ka plotesuar te gjitha kriteret e veçanta te kapacitetit ekonomik dhe financiar.

Kapaciteti teknik

1. Operatori ekonomik "NOVAKTI" sh.p.k nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi apo dokument që vërteton lidhjen ndërmjet Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit te kerkuar nga Autoriteti Kontraktor sipas pikes 2 te DST.
2. Operatori ekonomik "NOVAKTI" sh.p.k nuk ka paraqitur deklarate nga prodhuesi i mjeteve ose nga Distributori i Autorizuar qe garanton mbulimin e periudhes se garancise se mjeteve per nje periudhe 2 vjecare te kerkuar nga autoriteti kontraktor sipas pikes 3 te DST.

Kritere te tjera

Operatori ekonomik "NOVAKTI" sh.p.k ne Shtojcen 1, Formulari i ofertes ka paraqitur oferten per 1 mjet kamioncine vetshkarkuese ne vleren 5 680 000 leke pa TVSH, nderkohe qe sasia e kerkuar nga autoriteti kontraktor eshte per 2 mjete kamioncine vetshkarkuese.

Autoriteti kontraktor Agjencia e Sherbimieve Funerale ka llogaritur fondin limit ne vleren 6 991 626 leke pa TVSH, per lotin 1: "Blerje automjet kamioncine vetshkarkuese" per dy mjete kamioncine vetshkarkuese referuar edhe shtojces 12 "Sasia dhe grafiku i levrimet" te DST.

Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "NOVAKTI" sh.p.k ne vleren 5 680 000 leke pa TVSH nuk mbulon sasine e kerkuar nga autoriteti kontraktor dhe per kete arsye, oferta refuzohet.

Ne zbatim te nenit 53 pika 3 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006, "Per Prokurim Publik" (te ndryshuar) "*Autoriteti kontraktor; ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit.....*", per sa me siper oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "NOVAKTI" sh.p.k shpallet i pavlefshme, pasi nuk ploteson te gjitha kriteret e kerkuara nga autoriteti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Funerale ne dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë "**ALBANIAN MOTOR COMPANY**" sh.p.k me Adrese: Autostrada Tirane-Durres, Km 10, Kashar, Tirane se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **6 497 500 (gjashte milion e katerqind e nentdhjete e shtate mije e peseqind) leke pa TVSH/pikët totale të marra** [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Agjencia e Sherbimeve Funerale me adrese Rr. "Durresit", nr.132, Tirane* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 28.12.2018

Ankesa: ka ose jo Nuk ka patur ankesa
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

